

VENDIM
Nr. 160, datë 17.3.2021

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
PËRDORIMIN E FONDEVE TË MBETURA NGA PROGRAMI “MBROJTJA
MJEDISORE E LIQENIT TË SHKODRËS”, PËR T’U PËRDORUR PËR
FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË BORXHIT PËR MARRËVESHJEN E HUAS PËR
PROGRAMIN “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për përdorimin e fondeve të mbetura nga programi “Mbrotja mjedisore e liqenit të Shkodrës”, për t’u përdorur për financimin e shërbimit të borxhit për marrëveshjen e huas, për programin “Infrastruktura bashkiake II”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Datë 20.9.2019

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të (nëpërmjet *email-it*)
UK Shkodër
Shkodër
Email: uks@ukshkodër-al.com

LEa4: Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë
Furnizimi me ujë dhe mbrotja mjedisore e liqenit të Shkodrës
BMZ ID 2002 66 676 EUR 10,500,000.00

Shërbimi i Borxhit për Programin e Infrastrukturës Bashkiake II (hua e butë)
(BMZ ID 2010 66 315)

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Bashkëpunimit Financiar gjerman me Shqipërinë, në kuadrin e projektit të furnizimit me ujë dhe të mbrotjes mjedisore të liqenit të Shkodrës (BMZ ID 2002 66 676). Projekti paraqet fonde të mbetura në shumën prej 9.781.44 eurosh.

Ne propozojmë të përdorim fondet e mbetura në shumën prej **9.781.44 eurosh**, për shërbimin e borxhit për projektin Infrastruktura Bashkiake II (hua e butë) BMZ 2010 66 315.

Ne kërkojmë të jepni pëlqimin tuaj për përdorimin e përshkruar më sipër të fondeve të mbetura, duke nënshkruar dhe duke kthyer një kopje të kësaj letre.

Me respekt,
KfW
Dr. Kirk Mildner
Shefi i Departamentit

Stephan Raabe
Menaxher i Projektit

Lexuar dhe rënë dakord

Vendi, data, nënshkrimi

Emri: Anila Denaj
Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë